



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:260272

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05702253

**C.nr.1313/19**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditësit I.G. nga Ferizaj, Rr."A. B." nr., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO, Distrikti në Ferizaj, e perfaqesuar nga Diellza Lukaj, për shkak të lirimit të pronës, jashtë seance, më dt.16.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Padia e paditësit I.G. nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurës Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO, Distrikti në Ferizaj, për shkak të lirimit të pronës, **KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR.**

### **A r s y e t i m i**

Paditësi kundër të paditures ka ushtruar padi në këtë gjykatë me 08.11.2019, me kërkesë për lirimin e pronës .

Gjykata për çështjen kontestuese ka caktuar seancën gjyqësore më datën 16.05.2024, ku paditësi dhe e paditura kanë qenë të ftuar me rregull, kjo është konstatuar nga fletëkthesa e datës 03.05.2024, e pranuar me rregull nga paditësi. Në seancë ka prezentuar vetëm përfaqësuesi i palës së paditur, e cila i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit t'a konsiderojë të tërhequr.

Gjykata ka konstatuar se paditësi edhe pse është ftuar me rregull për këtë seancë, i njejti nuk ka prezentuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar e as shtyrjen nuk e ka kërkuar, andaj, vendosi që padinë e paditësit ta konsideroj si të tërhequr.

Gjykata, konform nenit 409 par.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**C.nr.1313/19, më datë 16.05.2024**

**Gjyqtari,  
Bekim Salihu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.